



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA



Në emër të lirisë së shprehjes
U ime slobode izražavanja
In the name of freedom of expression



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

Në emër të lirisë së shprehjes

Programi i të Drejtave të Njeriut
dhe ky publikim janë përkrahur nga
Mbrojtësit e të Drejtave Civile



Prishtinë,
Janar 2014



Botues:

Nisma e të rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë

Redaktore:

Raba Gjoshi

Hulumtues:

Natyra Avdiu

Edona Tolaj

Asistent hulumtues:

Granit Gashi

Dizajni & shtypi:

Printing Press

Tirazhi:

400



© Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë

www.ks.yihr.org

PËRMBAJTJA

1. Përmbledhje ekzekutive.....	5
2. Metodologjia.....	6
3. Baza ligjore dhe zbatimi i saj.....	6
4. Plani Rabat.....	9
5. Roli i KPM-së dhe KMSHK-së në adresimin e gjuhës së urrejtjes.....	10
6. LGBT dhe minoritetet të “rrezikuara” nga gjuha e urrejtjes.....	12
“Pederat” dhe thirrja për dhunë.....	13
“Shkije” dhe “magjup” – shprehjet e zakonshme në komente.....	16
Qëndrimet e redaksive rreth gjuhës së urrejtjes.....	19
7. Shembuj pozitiv.....	20
8. Raste ilustrative.....	21
Kosovo 2.0.....	21
Alma Lama.....	22
“Vajza rome”.....	22
“Gjenocidi modern”.....	23
9. Ankesat strategjike të YIHR KS-së.....	24
Telegrafi.com.....	24
Indeksonline.net.....	25
10. Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	25
11. Përfundim.....	27
12. Rekomandimet.....	28

Sqarim

Çdo fjalë që mund të konsiderohet diskriminuese, denigruese, ose të nxitë urrejtje apo që mund të jetë në kundërshtim me kodin e etikës dhe legjislacionin në fuqi, që figuron në këtë hulumtim, është cituar nga hulumtimi dhe është përdorur vetëm për treguar nivelin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes. Kjo gjuhë në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i YIHR KS-së.

1. Përmbledhje Ekzekutive

Gjuha e urrejtjes në Kosovë ndalohe dhe penalizohet me Kod Penal por edhe me kodet e etikës dhe sjelljes të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës dhe të Komisionit të Pavarur të Mediave. Në aspektin penal, gjuha e urrejtjes për herë të parë është kriminalizuar me Kodin Penal të ish Jugosllavisë. Aktualisht, ajo ndalohe edhe me Kodin Penal të Kosovës. Mirëpo, krimet e urrejtjes të kryera deri më 20 qershor 2013 nuk do të ndjeken apo dënohen, pasi që ligji kundërthënës për amnisti ka amnistuar kryesit apo të dyshuarit e krimeve të nxitjes së urrejtjes.

Edhe pse ligji për amnisti nuk hyri në fuqi deri më 20 qershor 2013, institucionet si policia e gjykatat, përfshirë edhe Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), kanë trajtuar numër jashtëzakonisht të vogël të krimeve të urrejtjes. Për tri vjet gjykatat kanë pranuar 13 raste ndërsa Prokuroria e Kosovës nuk ka ofruar të dhëna rreth ndjekjes së këtyre krimeve. Në anën tjetër, në Komisionin e Pavarur të Mediave nuk është paraqitur asnjë ankesë për përdorim të gjuhës së urrejtjes në mediat elektronike. Kurse, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës që ka trajtuar 11 raste ku ka gjetur shkelje nga mediat online, nuk ka fuqinë e duhur juridike që të ndikojë në zvogëlimin e këtyre rasteve.

Monitorimi i nëntë ueb-faqeve të lajmeve përgjatë viteve 2012 dhe 2013 tregon se shumica e portaleve nuk filtrojnë fare komentet duke lejuar gjuhë të urrejtjes përmes shprehjeve fyese, denigruese, poshtëruese dhe shpeshherë edhe thirrjeve për dhunë ndaj personave apo grupeve të caktuara. Shënimi se “nuk do të lejohen komente që përmbajnë gjuhë të urrejtjes...” të cilën e kanë disa portale të këndi i komenteve të lexuesve, është dëshmuar të jetë një shënim që as vetë portalet nuk e respektojnë, duke lejuar përmbajtje që nxitë urrejtje.

Grupet më të targetuara nga lexuesit, sipas të gjeturave të monitorimit të YIHR KS, janë komuniteti LGBT dhe minoritetet etnike, veçanërisht ai Serb. Ndërsa, shprehje denigruese janë përdorur edhe në temat që kanë të bëjnë me veriun e Kosovës apo dialogun Kosovë - Serbi. Shprehjet si “shkije”, “magjup”, “pedera”, janë të zakonshme në shumicën e portaleve, me disa përjashtime.

Hulumtimi poashtu ka identifikuar edhe shembuj pozitiv në mesin e mediave online të cilat me përpikëri dhe kujdes të veçantë filtrojnë komentet duke mos lejuar shprehje që nuk janë në pajtim me kodin e etikës apo legjisllacionin vendor.

Duke pasur parasysh që rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes do të duhej të trajtoheshin nga sistemi gjyqësor, raporti ofron elaborim të shkurtër të pesë rasteve kryesore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Këto raste kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes me shpresën që do të merren në konsideratë nga gjykatësit, prokurorët dhe avokatët vendorë.

Përfundimisht raporti ofron rekomandime konkrete për redaksitë e mediave online, për Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës, për prokurorinë, gjykatat dhe avokatët.

2. Metodologjia

Ky raport është bazuar kryesisht në monitorimin e mediave online. Poashtu, janë marrë në konsideratë edhe metodat cilësore dhe sasimore të kërkimit të të dhënave. Fokus të veçantë gjatë monitorimit të mediave online kanë pasur komentet e lexuesve pasi që ajo përmbajtje konsiderohet si më pak e redaktuar ose aspak e kontrolluar. Përveç të dhënave të gjetura përmes monitorimit, raportet ekzistuese, arkivat mediale, ligjet, kodet etike dhe materialet tjera janë përdorur për të pasuruar raportin dhe për të sjellë një pasqyrë më reale rreth gjuhës së urrejtjes në mediat online. Poashtu, gjatë hulumtimit, në mungesë të të dhënave online janë kontaktuar një numër i madh i institucioneve. Përfundimisht, meqenëse ky raport do të përmend shumicën e mediave online pronarët, redaktorët ose personat tjerë përgjegjës janë kontaktuar për të marrë qëndrimin e tyre rreth të gjeturave të monitorimit të YIHR KS-së.¹

3. Baza ligjore dhe zbatimi i saj

Mungesa e tolerancës ndaj grupeve të caktuara të shoqërisë çon shpeshherë në veprime që nxisin urrejtjen, e që më pas mund të rezultojnë në kryerjen e veprave penale. Urrëjtja mund të nxitet në forma të ndryshme, por ky raport fokusohet në gjuhën e urrejtjes të përdorur kryesisht në mediat online dhe raporti i saj me lirinë e të shprehurit.

Në diskursin publik në Kosovë gjuha e urrejtjes arsyetohet me lirinë e shprehjes, por baza ligjore ndërkombëtare dhe ajo vendore përcakton se liria e shprehjes nuk është e pakufizuar. Në fakt, një ndër elementet vendimtare në kufizimin e lirisë së shprehjes është rreziku që mund të vijë për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, gjë që mund të rezultojë në dëmtimin dhe rrezikimin e personave.

Dy nenet kryesore të Kushtetutës së Kosovës që rregullojnë lirinë e shprehjes dhe të mediave, ofrojnë referencë të qartë të rasteve kur liria e shprehjes dhe e mediave mund të kufizohet ligjërisht. Sipas nenit 40 të Kushtetutës së Kosovës, “liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”.² Poashtu, neni 42 i Kushtetutës, kur flet për ndalimin e censurës, bën të qartë që në fakt “censura” mund të aplikohet kur është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në bazë të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.³

Mirëpo, çfarë domethënie ka gjuha e urrejtjes dhe si definohet ajo? Deri më tani nuk ekziston një definicion i vetëm për gjuhën e urrejtjes, por më së shpeshti përdoret definicioni i dhënë nga Këshilli i Evropës, sipas së cilit gjuhë e urrejtjes janë “të gjitha format e shprehjes të cilat shpërndajnë, nxisin, promovojnë apo arsyetojnë urrejtjen

¹ Redaksitë janë kontaktuar përmes kontakteve që figurojnë në web-faqet e tyre.

² Kushtetuta e Kosovës, neni 40, liria e shprehjes, mund të gjendet në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

³ Kushtetuta e Kosovës, neni 42, liria e mediave, mund të gjendet në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

raciale, ksenofobinë, anti-semetizmin apo format tjera të urrejtjes të bazuara në jotolerancë, duke përfshirë: jo tolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv dhe etnocentrizmi, diskriminimin dhe armiqësinë kundër minoriteteve, migrantëve dhe njerëzve me origjinë imigruese”.⁴ Përveç rekomandimit të Këshillit të Evropës që ofron një definicion për gjuhën e urrejtjes, ekziston një numër i madh i instrumenteve ndërkombëtare që dënojnë dhe ndalojnë të gjitha format e nxitjes së urrejtjes.

Edhe pse Kosova nuk është nënshkruese e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, apo anëtare e Këshillit të Evropës, Kushtetuta parasheh që instrumentet ndërkombëtare të zbatohen dhe në rast konflikti me legjislacionin e institucioneve të Kosovës, ato të kenë përparësi.⁵

Mbrojte nga nxitja e urrejtjes ofron Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndonëse nuk i jep referencë të qartë terminologjisë “nxitje e urrejtjes”. Neni 10 që ka të bëjë me lirinë e shprehjes kufizon këtë të drejtë në paragrafin e dytë, ndër të tjera, edhe kur ajo është e domosdoshme për “ndalimin e krimeve, për mbrojtjen e shëndetit dhe moralit, për mbrojtjen e reputacionit apo të drejtave të të tjerëve”.⁶

Ndërsa në aspektin penal, përdorimi i gjuhës që nxit urrejtje racore, kombëtare dhe lloje të tjera është kriminalizuar për herë të parë me kodin penal të ish-Jugosllavisë të vitit 1952, i cili është marrë si shembull nga shumë juridiksione.⁷

Në Kosovë, që nga 1 janari i viti 2013 kur Kodi i ri Penal hyri në fuqi, nxitja e urrejtjes dënohet penalisht me gjobë dhe deri në dhjetë vjet burg.⁸ Kjo vepër penale ka ekzistuar edhe në Kodin e vjetër Penal.⁹ Mirëpo, të gjithë ata persona që kanë kryer këtë vepër penale para datës 20 qershor 2013, me cilindo Kod Penal që ka qenë në fuqi, u është dhënë lirim i plotë nga ndjekja penale apo vuajtja e plotë e dënimit me ligjin kundërtënë për amnistinë, që u miratua në Parlament më 11 korrik 2013.¹⁰

Sidoqoftë, zbatimi i legjislacionit penal për krimet që kanë të bëjnë me nxitjen e urrejtjes, atëherë kur nuk ishte pjesë i ligjit për amnistinë, nuk duket të ketë qenë prioritet për institucionet publike e sidomos sistemin gjyqësor, bazuar në të dhënat zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

⁴ Rekomandimi nr. R (97) 20 i Këshillit të Evropës, mund të gjendet në:

[http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dh-lgbt_docs/CM_Rec\(97\)20_en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/hrpolicy/other_committees/dh-lgbt_docs/CM_Rec(97)20_en.pdf)

⁵ Kushtetuta e Kosovës, neni 22, Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, mund të gjendet në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

⁶ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 10, Liria e Shprehjes, mund të gjendet në:

http://www.echr.coe.int/Do cuments/Convention_ENG.pdf

⁷ Vejdeland dhe të tjerët v. Suedia, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 9 shkurt 2012, fq 19, mund të gjendet në:

<http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/pages/search.aspx?i=001-109046>

⁸ Kodi Penal, neni 147, Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, mund të gjendet në:

[http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Kodi%20Penal%20i%20R.Kosoves%20\(shqip\).pdf](http://gazetazyrtare.rks-gov.net/Documents/Kodi%20Penal%20i%20R.Kosoves%20(shqip).pdf)

⁹ Kodi i Përkohshëm Penal, neni 115, Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik, mund të gjendet në: http://gazetajnk.com/repositor y/docs/RA2003_25_CCintranet_295748.pdf

¹⁰ Ligji për Amnistinë, 11 korrik 2013, mund të gjendet në:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/d ocs/ligjet/Ligji%20per%20amnistine.pdf>

Sipas të dhënave të KGJK-së që kanë të bëjnë për periudhën kohore janar 2008 - shtator 2013 ekzistojnë gjithsej 13 raste për veprën penale të nxitjes së urrejtjes, ku prej tyre 5 janë të zgjidhura dhe 8 të pazgjidhura.¹¹ Zyrtarisht, këto të dhëna nuk figurojnë online pasi që Këshilli Gjyqësor i Kosovës në raportin vjetor ndan lëndët gjyqësore në ato penale dhe civile, por nuk ofron të dhëna statistikore sipas veprës penale të gjykuar.¹²

8

Shifra prej 13 rastesh është jashtëzakonisht e ulët në krahasim me trendin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes, që hyn në kuadër të krimeve të urrejtjes, dhe trendin e rasteve të shqyrtuara nga gjykatat e rregullta në Kosovë. Sipas të dhënave të KGJK-së, gjykatat në Kosovë në baza vjetore trajtojnë rreth 100 mijë lëndë gjyqësore, pa llogaritur lëndët e trashëguara nga periudhat paraprake të cilat arrijnë shifrën prej 216, 860 lëndë.¹³

Policia e Kosovës, po ashtu ka evidentuar një numër të vogël të rasteve që kanë të bëjnë me veprën penale të nxitjes së urrejtjes. Për periudhën kohore prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2013 figurojnë gjithsej 8 raste të regjistruara në databazën e Policisë.¹⁴

Prokuroria e Kosovës nuk ka ofruar të dhëna për numrin e rasteve të hetuara nga prokurorët për veprën penale nxitje e urrejtjes, e dënueshme sipas Kodit Penal të Kosovës.¹⁵ Përderisa Prokuroria e Kosovës nuk ofron të dhëna lidhur me krimet e urrejtjes, në Angli dhe Uells, ndjekja e personave që kanë kryer krime të urrejtjes arriti kulmin më 2010 dhe 2011, ku 13, 276 persona u paraqiten para gjykatave.¹⁶ Të dhënat përfshijnë edhe rastet kur viktimat janë targetuar bazuar në orientimin e tyre seksual, derisa numri më i madh i rasteve ishin të motivuara nga përkatësia racore.¹⁷

Në anën tjetër, prokurorët dhe gjykatësit që përmes trajnimeve përgatiten nga Instituti Gjyqësor i Kosovës për të ushtruar veprimtarinë e tyre, nuk marrin ndonjë trajnim specifik lidhur me veprat penale të nxitjes së urrejtjes, apo vepra penale që nxiten nga urrejtja.¹⁸ Trajnimi i policëve, prokurorëve dhe gjykatësve se si të adresojnë krimet e urrejtjes është tashmë prioritet në vendet evropiane. Kjo është ritheksuar edhe në konferencën “Luftimi i krimeve të urrejtjes në BE”, e mbajtur në nëntor të vitit të kaluar në Letoni, ku është rekomanduar që “trajnimi për krimet e urrejtjes duhet të jetë pjesë e trajnimit fillestar për policë, dhe ky trajnim duhet t’u ofrohet edhe gjykatësve dhe prokurorëve...”.¹⁹ Ndërkohë, Oda e Avokatëve të Kosovës më 2012 ka ofruar trajnime për krimet e urrejtjes për avokatët e saj në gjashtë komuna.²⁰

¹¹ Të dhënat janë nxjerrur manualisht nga ekipi i YIHR KS-së bazuar në statistikat që KGJK ka ofruar për të gjitha lëndët.

¹² Ndarja e lëndëve varet nga gjykata. Për shembull në kundërvajtje lëndët ndahen në kundërvajtje nga komunikacioni, ekonomia, rendi dhe qetësia publike, siguria publike etj.

¹³ Raporti vjetor i KGJK-së, 2012, mund të gjendet në: http://www.kgjk-ks.org/repository/docs/raporti_final_ALB_2012_725938.pdf

¹⁴ Përgjigje nga zyra për informim e policisë, 10 janar 2014

¹⁵ YIHR KS ka kërkuar me shkrim të dhëna nga prokuroria përmes zëdhënësës Liridona Kozmaqi por nuk ka pranuar përgjigje.

¹⁶ Ndjekja e krimeve të urrejtjes arrin rekordin, 14 shkurt 2012, BBC, mund të gjendet në: <http://www.bbc.co.uk/nees/uk-17029139>

¹⁷ Ibid

¹⁸ Përgjigje nga Gentiana Elshani, zyrtare ndërlidhëse në Institutin Gjyqësor të Kosovës, 10 janar 2014

¹⁹ Rekomandime të grupit punues gjatë punimeve të konferencës, mund të gjendet në:

http://fra.europa.eu/sites/default/files/frc_2013_day_2_ëg_iii_ëorking_group_harvest_capacity_building_and_training.pdf

²⁰ Përgjigje nga Albulena Ukimeraj, Koordinatorë e Qendrës Trajnuese të Odës së Avokatëve të Kosovës, 10 janar 2014

Pesë raste të tjera janë duke u hetuar edhe nga prokurorët e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Dy nga këto raste janë me Prokurorinë Speciale të Kosovës, dy me Ekipin Mobil të Prokurorëve dhe një me Task Forcën për Mitrovicë.²¹

4. Plani Rabat

Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, organizoi katër punëtori rajonale me ekspertë që vinin nga të gjitha anët e globit. Gjatë mbajtjes së punëtorëve, doli Plani i Veprimit Rabat (Plani Rabat), qëllimi i të cilit është që të shërbejë si udhëzues për krijimin e një bilanci në mes të Nenit 19 (i cili trajton lirinë e shprehjes) dhe Nenit 20 (që trajton nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.²²

Plani Rabat u jep rekomandime shteteve për masat pozitive që ato duhet të ndërmarrin në fushën e përmirësimit të legjislationit, praktikës gjyqësore dhe politikave të tyre shtetërore për të luftuar gjuhën e urrejtjes.

Sa i përket legjislationit, Plani Rabat inkurajon shtetet që në legjislationin e tyre të definojnë sa më konkretisht nxitjen për diskriminim, armiqësi dhe dhunë. Për më tepër, për çdo kufizim që shtetet i bëjnë lirisë së shprehjes, duhet të kenë parasysh tri kushte: ligjshmërinë, proporcionalitetin dhe domosdoshmërinë.

Ndërsa, në zhvillimin e praktikës gjyqësore, Plani Rabat ofron një test prej 6 pikave të cilin gjykatat duhet ta kenë parasysh në rastet kur duhet të vlerësojnë nëse një gjuhë e caktuar duhet të ndalohej apo të ndëshkohet si gjuhë nxitëse.

Gjashtë pikat e testit janë:

- 1) konteksti në të cilën është thënë diçka;
- 2) folësi;
- 3) qëllimi i folësit;
- 4) përmbajtja apo forma e fjalimit;
- 5) shtrirja ose përhapja e fjalimit dhe
- 6) rreziku apo gjasat që si rezultat i asaj gjuhe të ndodhë nxitja e urrejtjes.

Ndërsa, sa i përket sanksioneve të aplikuara nga ana e shtetit, Plani Rabat rekomandon që sanksionet penale të shqiptohen vetëm në raste më të rënda. Për rastet më të lehta të ndërmerren masa administrative apo masa tjera.

Plani Rabat iu rekomandon shteteve që të aplikojnë politika të cilat promovojnë paqe, tolerancë, bashkëpunim dhe mirëkuptim në mes të individëve, grupeve etnike, religjioze,

²¹ Përgjigje nga Blerim Krasniqi, zëdhënës në EULEX, 13 janar 2014

²² Punëtoritë janë mbajtur në vende të ndryshme. Punëtorja e parë është mbajtur në Vjenë më 9 dhe 10 shkurt 2011, e dyta në Afrikë, Nairobi, më 6 dhe 7 prill 2011, e tretë në Azi, Bangkok, më 6 dhe 7 korrik 2011, e katërta në dy Amerikat, Santiago Kili, më 12 dhe 13 Tetor 2011 ndërsa takimi final është mbajtur në Maroko, Rabat më 4 dhe 5 tetor 2012.

udhëheqësve fetar, akterëve shtetërorë, mediave dhe të ngritin vetëdijen shoqërore me qëllim të ndalimit të akteve të nxitjes së urrejtjes. Ky plan mund të shërbej si shembull praktik për institucionet vendore në adresimin e gjuhës së urrejtjes.

5. Roli i KPM-së dhe KMSHK-së në adresimin e gjuhës së urrejtjes

Në Kosovë ekzistojnë mekanizma të ndryshëm që mund të përdoren për të adresuar gjuhën e urrejtjes në media. Mekanizmat gjyqësor përfshijnë policinë, prokurorinë dhe gjykatat, ndërsa mekanizmat tjerë shtetëror ose vetë-rregullues (jo shtetëror) janë Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK). Edhe pse, ky raport fokusohet në mediat online, konsiderojmë që është e nevojshme të shpjegohet edhe roli i KPM-së pasi që ai monitoron punën e mediave elektronike.

Në mënyrë që mekanizmat ekzistues të funksionojnë, rastet e përdorimit të gjuhës së urrejtjes duhet të raportohen në polici, të cilët janë të obliguar të hetojnë rastin dhe në bashkëpunim me prokurorinë të vendosin nëse duhet të ngrihen akuza për përdorim të gjuhës së urrejtjes. Krimet që kanë të bëjnë me nxitjen e urrejtjes, këtu hyn edhe përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga mediat, mund të ndiqen nga prokuroria edhe sipas detyrës zyrtare, pra pa e raportuar fare rastin. Prokuroria nuk ka ofruar të dhëna se sa raste ka hetuar. Lidhur me rastet e trajtuara nga këta mekanizma u tha më lartë, por ekzistojnë edhe mekanizma tjerë jashtë sistemit gjyqësor, që mund të ndikojnë në ndalimin dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes në media.

Mekanizëm i tillë konsiderohet edhe Komisioni i Pavarur i Mediave. Ky institucion i themeluar nga Kuvendi i Kosovës monitoron mediat elektronike (televizionet dhe radiot), nëse ato veprojnë në pajtim me kodin e sjelljes së mediave audiovizuale dhe qytetarët kanë të drejtë të bëjnë ankesë kundër medimeve për transmetim të gjuhës që nxitë urrejtje.

Kodi i sjelljes së KPM-së ndalon transmetimin e përmbajtjes programore që nxitë urrejtje mbi baza të përkatësisë etnike, religjioze, gjinore, racore, martesore, të moshës apo të paaftësisë fizike e mendore.²³ Poashtu, mediumet nuk guxojnë të transmetojnë përmbajtje që nxitë veprime kriminale.²⁴ Sipas të dhënave të ofruara nga KPM, ky institucion nuk ka trajtuar ndonjë rast që ka të bëjë me përdorimin e gjuhës së urrejtjes në televizione apo radio.²⁵

Në krahasim me vitet e pas luftës në Kosovë, vërehet një rënie e theksuar e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në gazetat ditore, por ky nuk është rasti edhe me mediat online. Nivel më i lartë i gjuhës së urrejtjes paraqitet në portalet online të lajmeve, të cilat ashtu sikurse mediat e shkruara rregullohen nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës. KMSHK është trup vetë-rregullativ që përbëhet nga përfaqësuesit e mediave të shkruara

²³ Kodi i Sjelljes për Shërbimet Mediale Audio Vizuale në Republikën e Kosovës, neni 10, mund të gjendet në: <http://kpm-ks.org/materiale/dokument/1292592101.0176.pdf>

²⁴ Ibid.

²⁵ Përgjigje nga Fikrete Çoçaj, zëdhënëse e Komisionit të Pavarur të Mediave, 20 janar 2014

dhe online, dhe funksionon në baza vullnetare. KMSHK-ja nuk ka fuqi juridike dhe nuk mund të imponoj sanksione me gjobë, andaj puna e tij varet nga vullneti i industrisë mediale për të zbatuar kodin dhe vendimet e saj.

Ankesat në KMSHK mund të parashtrohen nga kushdo, mirëpo ankesat anonime nuk merren fare parasysh nga Këshilli.²⁶ Poashtu, sipas rregullave të procedurës së Këshillit ankesat duhet të parashtrohen kundër mediumit dhe jo kundër gazetarëve individualisht.²⁷

KMSHK nuk ka ndonjë statistikë zyrtare për numrin e vendimeve që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes.²⁸ Mirëpo, në faqen zyrtare figurojnë 11 vendime dhe opinione që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes, të cilat ky Këshill ka trajtuar që nga viti 2009. Gjashtë prej tyre janë vendime dhe katër opinione. Dy nga 11 ankesat janë refuzuar, 5 janë miratuar, 3 prej tyre janë miratuar pjesërisht dhe 1 nuk është miratuar.²⁹

Lidhur me përgjegjësinë e mediave, sidomos atyre online, ekziston një përshtypje e përgjithshme që mediat online nuk mbajnë përgjegjësi për komentet e lexuesve, qoftë kur ato ofrohen nën shkrime apo në formë të opinioneve apo kolumneve. Kjo dëshmohet edhe me faktin që shumica e portaleve vendosin, zakonisht nën shkrim, një shënim për heqje të përgjegjësisë ku ndër të tjera thuhet se “portali nuk mban përgjegjësi” ose edhe që “ndalohen komentet që nxisin urrejtje”.

Këtë shënim aktualisht e kanë ndeksonline.net, Telegrafi.com, Koha.net, Tribunashqiptare dhe Gazetajetnekosove.com. Ndërsa, vetëm Telegrafi.com, Gazetajetnekosove.com dhe Tribunashqiptare.com shprehimisht ndalojnë gjuhën e urrejtjes. Botasot.info, Zeri.info dhe Lajmi.net, nuk përmbajnë fare këtë shënim.

Megjithatë, më poshtë do të elaborohen rastet ku shumica e portaleve fare nuk u përmbahen këtij shënimi dhe duket se ai shënim është vetëm një “copy-paste”, që bëhet nga portalet për tu dukur kinse do të veprojnë në përputhje me kodin e etikës dhe ligjet në fuqi. Përderisa ky shënim duhet të ekzistoj por edhe të respektohet, është e nevojshme që portalet që nuk e përmbajnë këtë shënim, të gjejnë një formë për t’i shpjeguar lexuesit kriteret kryesore të cilave ai/ajo duhet t’iu përmbahet gjatë komentimit. Kjo pastaj do t’i jepte të drejtë mediumit që të redaktojë/largojë komentet, bazuar në mos respektimin e standardeve të vëna, për të cilat duhet të informohet komentuesi.

Në anën tjetër, mos publikimi i një komenti apo largimi i tij pa i ofruar komentuesit arsytim mund të konsiderohet, nga lexuesit me plot të drejtë si censurë. Një shembull pozitiv në këtë aspekt është gazetajn.com, e cila gjatë monitorimit është vërejtur që ka një numër të madh të komenteve të fshira dhe në ato raste tek komenti figuron

²⁶ Rregullat e Proedurës, neni 2, mund të gjendet në: <http://presscouncil-ks.org/?cid=1,11>

²⁷ Ibid

²⁸ Përgjigje nga Qerim Ondozi, zyrtar për marrëdhënie me publikun, KMSHK, 15 janar 2014

²⁹ Të dhënat janë marrë nga faqja zyrtare e KMSHK-së, <http://presscouncil-ks.org/>

arsyetimi se pse është fshirë apo nuk është publikuar komentit.³⁰ Kjo zgjidhje mund të konsiderohet si një balansim në mes të së drejtës së lexuesit për t'u shprehur dhe të drejtës së mediumit për të mbrojtur të tjerët.

Përgjegjësia mediale, poashtu është konfirmuar edhe me rastin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila kishte vendosur që gjykatat në Estoni nuk bënë shkelje të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur dënuan portalin Delfi me 320 euro për publikimin e komenteve fyese dhe ofenduese. Vendimi ende nuk është i plotfuqishëm pasi që ndaj tij është ushtruar ankesë.

Më 2006 portali Delfi, njëri ndër portalet më të mëdha të lajmeve në Estoni, botoi një shkrim me të cilin analizonte vendimin e një kompanie që kishte ndryshuar rrugën që bënin anijet për të arritur në disa ishuj. Vështirësitë gjatë zbatimit të këtij vendimi kishin bërë që të shtyhet shfrytëzimi i një linje të anijeve që ofronte çmime më të lira për qytetarët estonez. Shumë lexues kishin postuar komente fyese dhe kërcënuese për kompaninë e anijeve dhe pronarin e saj, në shenjë revolte ndaj ngritjes së çmimeve. Për këtë arsye, po atë vit më 2006, pronari i kompanisë së anijeve kishte paditur portalin Delfi në Estoni, gjykata e të cilit shtet kishte vendosur në favor të tij. Sipas gjykatës estoneze, komentet ishin fyese dhe Delfi mbante përgjegjësi për publikimin e tyre. Pronari i kompanisë së anijeve ishte kompensuar me 320 euro për dëmin. Ankesa e Delfit në Gjykatën Supreme të Estonisë po ashtu kishte qenë e pasuksesshme. Portali Delfi kishte ushtruar ankesë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nën arsyetimin se shteti i Estonisë kishte shkelur të drejtën e shprehjes së lirë që rregullohet me nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur vendosi ta mbante përgjegjës për komente.³¹

Ky vendim është kritikuar në masë të madhe nga organizatat mediale të cilat kanë inkurajuar Delfi AS të parashtroj rastin në shkallën e dytë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.³² Kështu, më 8 janar 2014, Delfi AS ka parashtuar kërkesë që ky rast të referohet në Dhomën e Madhe (shkallën e dytë), kërkesë kjo e mbështetur nga koalicioni i 69 organizatave në mes të të cilave bëjnë pjesë Google, Guardian News and Media, The New York Times, Article 19 etj.³³

6. LGBT dhe minoritetet të “rrezikuara” nga gjuha e urrejtjes

YIHR KS përgjatë vitit 2012 dhe 2013³⁴ ka monitoruar trajtimin e gjuhës së urrejtjes në 9 ueb-faqe të lajmeve, përkatësisht në Botasot.info, Indeksonline.com,

³⁰ Rregullat e përdorimit, Gazeta Jeta në Kosovë, mund të gjendet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1,1061>

³¹ Portalet Ligjërisht Përgjegjëse për Komente, 11 tetor 2013, Gazeta Jeta në Kosovë, mund të gjendet në: <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,6644> (përshkrimi i rastit është huazuar nga Gazeta Jeta në Kosovë e cila raportoi për vendimin e Gjykatës)

³² Organizata ndërkombëtare Article 19 që merret me çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes i rekomandoi Delfi AS që të dërgojë rastin në shkallën e dytë.

³³ Delfi v Estonia, kërkesë për të referuar rastin në Grand Chamber, 15 janar 2014, mund të gjendet: <http://inform.ëordpress.com/2014/01/15/neës-delfi-v-estonia-liability-for-user-comments-applicant-seeks-referral-to-grand-chamber/>

³⁴ Gjatë monitorimit të arkivave mediale janë identifikuar edhe shkrime që datojnë para vitit 2012.

Gazetaexpress.com, Gazetajnk.com, Gazetatribuna.com, Koha.net, Lajmi.net, Telegrafi.com dhe Zeri.info. Përzgjedhja e shumicës prej tyre është bërë nga lista e anëtarëve të Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës.³⁵

Të dhënat e monitorimit tregojnë që gjuha e urrejtjes përdoret kryesisht në shkrimet që trajtojnë temat e komunitetit LGBT dhe minoriteteve etnike, sidomos kur ato kanë të bëjnë me minoritetin serb. Për shembull, nga monitorimi del se është përdorur dhe publikuar gjuhë e urrejtjes, sidomos gjatë ngjarjeve që kanë të bëjnë me Kosovo 2.0³⁶. Po ashtu, është vërejtur që në shumicën e shkrimeve ku është trajtuar çështja e bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë, çështja e statusit të veriut të Kosovës, zgjedhjeve në veri etj, ka pasur nivel më të lartë të publikimit të gjuhës së urrejtjes.

“Pederat” dhe thirrja për dhunë

Çështja e realizimit të të drejtave të komunitetit LGBT në Kosovë vazhdon të konsiderohet temë tabu dhe mediat përkundër ndjeshmërisë, duket të mos kenë treguar kujdes të mjaftueshëm gjatë trajtimit të kësaj teme. Sipas Raportit të Progresit të përpiluar nga Komisioni Evropian për vitin 2013, komuniteti LGBT në Kosovë përballet me sfida të shumta dhe vazhdon të ballafaqohet me diskriminim, kërcënime dhe dhunë.³⁷ Kjo e dhënë mbështetet edhe me të gjeturat e mbledhura gjatë monitorimit të mediave.

YIHR KS gjatë monitorimit të gjuhës së urrejtjes në media ka identifikuar mijëra komente të lexuesve në portale të ndryshme të cilët kanë nxitur urrejtje kundër komunitetit LGBT, kanë bërë thirrje për dhunë dhe kanë fyer e kanë poshtëruar këtë komunitet për shkak të orientimit të tyre seksual. Reagimi i medimeve ndaj fluksit të komenteve në këto raste, me përjashtim të dy portaleve³⁸ ka qenë i dobët dhe i papërgjegjshëm.³⁹

Botasot.info – Gjatë monitorimit të shkrimeve të këtij portali janë vërejtur komente të cilat përmbajnë më shumë fyerje dhe ofendime ndaj komunitetit LGBT, se sa thirrje për veprime penale. Krahasuar me portalet tjera të monitoruara, numri i shkrimeve që kanë pasur për tematikë çështjet e komunitetit LGBT duket të jetë më i vogël, andaj edhe numri i komenteve është më i vogël. Mirëpo, gjatë monitorimit janë hasur edhe shkrime për këtë tematikë që nuk përmbanin fare komente.⁴⁰

³⁵ Renditja e portaleve është bërë sipas rendit alfabetik.

³⁶ Kjo ngjarje do të elaborohet më poshtë.

³⁷ Raporti i Progresit 2013, Komisioni Evropian, 16 tetor 2013, mund të gjendet në:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf

³⁸ Gazetajnk.com dhe Lajmi.net

⁴⁰ Këta janë sulmuesit e komunitetit LGBT te Salla e Kuqe, 07 qershor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.botasot.info/kronike-e-zeze/226627/keta-jane-sulmuesit-e-komunitetit-lgbt-te-salla-e-kuqe/>

Dita ndërkombëtare kundër homofobisë, 17 maj 2013, mund të gjendet në: <http://www.botasot.info/kosova/223920/dita-nderkombetare-kunder-homofobise/>

Prishtinë, aksion për përkrahjen e komunitetit LGBT, 15 dhjetor 2012, mund të gjendet në:

<http://www.botasot.info/kosova/201770/prishtine-aksion-per-perkrahjen-e-komunitetit-lgbt/>

Indeksonline.com - Gjatë monitorimit të shkrimeve që ndërlidhen me komunitetin LGBT, YIHR KS ka vërejtur një numër jashtëzakonisht të madh të komenteve që nxisin urrejtje, bëjnë thirrje për veprime kriminale, dënojnë daljen publike të komunitetit LGBT, bëjnë thirrje për kundërshtimin e të drejtave të tyre në cilëndo formë, dhe poshtërojnë me shprehjet më të rënda këtë komunitet.⁴¹ Disa nga komentet e publikuara përfshijë por nuk kufizohen në: “All-lahu e rujt rinin tone prej njerzve te prisht”, “o ju jeni mendje te smuta ,ju jeni infektim i shoqerise,o te degjenerum ,o flliqesira”, “ju skeni vend kty na kena me ju kall”, “O peder . Peder nuk lind peder bohesh”, “Kurgjo s'paskan bo plisa prom. U desht me i lon ne vend aty e me i vra krejt aty nvend...”, “Per keta duhet bere furra prej gasi sikur Hitleri per jahudite!”, “shko moj flliqsire Bravo rusia qe nuk i len ata Ndytsira” etj.⁴²

Gazetaexpress.com – Gazeta Express, poashtu konsiderohej si një ndër mediumet që nuk ka filtruar komentet online dhe ka lejuar komente të shumta, që ndër të tjera, nxisnin urrejtje dhe bënin thirrje për veprime kriminale. Mirëpo, Gazeta Express ka vendosur të mbyll mundësinë e komentimit në shkrime. Bordi Editorial i Gazetës Express, në arsyetimin e tij të publikuar online ka thënë që vendimi është i përkohshëm deri në një zgjidhje tjetër, në mënyrë që “brenda komenteve të lexuesve askush të mos fyhet e poshtërohet vetëm se i përket një etnie të caktuar, religjioni, grupi politik apo një orientimi seksual”.⁴³

Gazetatribuna.com – është portal relativisht i ri dhe përmban shumë pak komente kundër komunitetit LGBT.⁴⁴ Mirëpo, duhet të theksohet fakti që në të paktën tri shkrime,

⁴¹ Më poshtë mund të gjeni disa nga linqet e shkrimeve të analizuara. YIHR KS posedon të gjitha shkrimet dhe komentet në kopje fizike

Aksion për përkrahjen e komunitetit LGBT, 15 dhjetor 2012, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqlD=2&LajmlD=40474>

Konferencë për Liritë dhe Mbrojtjen e Komunitetit LGBT në Kosovë, 12 dhjetor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqlD=2&LajmlD=78713>

Elton John flet për të drejtat e LGBT, 06 dhjetor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqlD=4&LajmlD=78181>

Ambasada amerikane dënon dhunën ndaj komunitetit LGBT, 17 dhjetor 2012, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqlD=2&LajmlD=40662>

Jacobson ngrit flamurin e LGBT-së në ambasadë, 17 maj 2013, mund të gjendet në:

<http://indeksonline.net/?FaqlD=2&LajmlD=58602>

Komuniteti LGBT, AP: Të rishikohen tekstet mësimore, 12 qershor 2012, mund të gjendet në:

<http://indeksonline.net/?FaqlD=2&LajmlD=21282>

Ambasadorja amerikane priti anëtarët dhe përkrahësit e LGBT, 29 mars 2013, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqlD=2&LajmlD=52808>

Sulmohen me gaz lotsjellës aktivistët e LGBT-së, 17 maj 2013, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqlD=2&LajmlD=58678>

Aksion për përkrahjen e komunitetit LGBT, 15 dhjetor 2012, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqlD=2&LajmlD=40474>

Homoseksualët, të enjten protestë para ministrisë së Drejtësisë, 11 prill 2013, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqlD=2&LajmlD=54318>

Një Gay Paradë edhe në Tiranë, 21 mars 2012, mund të gjendet në: <http://indeksonline.net/?FaqlD=4&LajmlD=17157>

⁴² Komentet nuk janë redaktuar qëllimisht.

⁴³ Gazeta Express suspendon komentet e lexuesve, mund të gjendet në: <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,15,130740>

⁴⁴ Komuniteti LGBT është i rrezikuar në Kosovë, 30 qershor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.gazetatribuna.com/?FaqlD=7&LajmlD=13793&thekso=LGBT>

në të cilat nuk trajtohej ndonjë temë lidhur me komunitetin në fjalë, është lejuar fjala “peder” në komente.⁴⁵

Koha.net – është medium që në një masë është treguar i kujdesshëm në filtrimin e komenteve, por në disa raste ka lejuar komente që nxisin urrejtje. Një ndër këto shkrime është ai për rastin e Kosovo 2.0, i cili do të elaborohet më poshtë, ku portali ka lejuar 101 komente. Këto komente, jo vetëm që nxisin urrejtje, por bëjnë thirrje për veprime kriminale si p.sh “Vdekje Bulashav, Vdekje Lesbikev, Vdekje degjenerimit.”⁴⁶ Disa prej komenteve të lejuara përdorin termin “shka” për të nxitur urrejtje kundër serbëve, i quajnë kafshë organizatorët e ngjarjes për publikimin e revistës Kosovo 2.0, përgëzojnë sulmuesit e ekipit të Kosovo 2.0 dhe bëjnë thirrje që të kundërshohet komuniteti LGBT.

Telegrafi.com - ky portal, ashtu si edhe Indeksonline.com, përmban nivel të lartë të komenteve që nxisin urrejtje ndaj komunitetit LGBT. Nga shkrimet e analizuara, vërehet që komentet kundër komunitetit LGBT vijjnë jo vetëm në rastet kur trajtohet kjo çështje me fokus në Kosovë, por mjafton që fjala LGBT të figurojë në titull që të nxitin komentet e tilla. Komentet e lexuesve, ndër të tjera, bëjnë thirrje për dhunë fizike ndaj homoseksualëve dhe lezbikëve, dhe dënimin publik të tyre.⁴⁷ Duhet veçuar shkrimi me titull “E plotësuar: “Kosovo 2.0”, largohen me ndihmën e policisë” i cili përmban 325 komente. Shumica prej komenteve shkelin kodin etik dhe mund të përbëjnë bazë për ndjekje penale. Disa nga këto komente janë: “organizatores te ksaj mbrenje pederash e lezbejkash duhet ti pritet koka”, “Elhamdulillah qe eshte shkaterruar nje maskaralleq.Allahu i shperblefte te gjithë ata qe kan kontribu qe me shkatrru nje

⁴⁵ Më poshtë mund të gjeni disa nga linqet e shkrimeve të analizuara. YIHR posedon të gjitha shkrimet dhe komentet në kopje fizike

Vëllezërit Grabovci policisë: A e dini kush jena na!?, 20 gusht 2013, mund të gjendet në:

<http://www.gazetatribuna.com/?FaqelD=2&LajmID=20113>

Dhurata në krahët e Labit, 17 qershor 2013, mund të gjendet në: <http://www.gazetatribuna.com/?FaqelD=5&LajmID=12059>

Skandal! Ministri bullgar,shqyen flamurin e Kosovës (Video), 11 korrik 2013, mund të gjendet në:

<http://www.gazetatribuna.com/?FaqelD=2&LajmID=15124>

⁴⁶ Ekstremistët demolojnë zyrën e “Kosovo 2.0”, 14 dhjetor 2012, mund të gjendet në: <http://koha.net/?page=1,13,127487>

⁴⁷ Më poshtë mund të gjeni disa nga linqet e shkrimeve të analizuara. YIHR posedon të gjitha shkrimet dhe komentet në kopje fizike

Parada LGBT në Serbi: Mbështetje nga aktivistë shqiptarë, 07 tetor 2012, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/parada-lgbt-ne-serbi-mbeshtetje-nga-aktiviste-shqiptare-video-2-25505.html>

E plotësuar: “Kosovo 2.0”, largohen me ndihmën e policisë, 14 dhjetor 2012, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/e-plotesuar-kosovo-2-0-largohen-me-ndihmen-e-policise-80-4386.html>

GSÇGJ: Të ndalen sulmet ndaj LGBT!, 19 dhjetor 2012, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/gscgj-te-ndalensulmet-ndaj-lgbt-2-27413.html>

Sulmohen me gaz lotsjellës aktivistët e LGBT –së, 17 maj 2013, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/sulmohen-me-gaz-lotsjell-s-aktivist-t-e-lgbt-s-78-9692.html>

Lady Gaga rikthehet, përkrah komunitetin LGBT, 29 qershor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/magazina/lady-gaga-rikthehet-perkrah-komunitetin-lgbt-6-19325.html>

Shqipëri, homoseksualët me çmime për përkrahësit e tyre, 27 janar 2013, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/magazina/shqiperi-homoseksualet-me-çmime-per-perkrahesit-e-tyre-6-17636.html>

Shqetësime serioze për të drejtat e njeriut në Kosovë, 24 maj 2012, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/shqetesime-serioze-per-te-drejtat-e-njeriut-ne-kosove-2-22622.html>

Marsh homoseksualësh edhe në Tiranë, 15 maj 2012, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/fun/marsh-homoseksualesh-edhe-ne-tirane-10-5977.html>

Kryeministri dhe IAP dënojnë sulmet ndaj “Kosovo 2.0”, 18 dhjetor 2012, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/kryeministri-dhe-iap-denojne-sulmet-ndaj-kosova-2-0-2-27365.html>

Paris, xhamia e parë për homoseksualë, 30 nëntor 2012, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/fun/paris-xhamia-e-pare-per-homoseksuale-10-6518.html>

Spahia nuk tërhiqet, kundër gay-paradës, 15 maj 2012, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/spahia-nuk-t-rihiket-kund-r-gay-parad-s-78-7564.html>

Spahia nuk tërhiqet, kundër gay-paradës, 15 maj 2012, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/spahia-nuk-t-rihiket-kund-r-gay-parad-s-78-7564.html>

fliqesire e tille. Allahu Ekber”, “he be morrat e nones ju keni met me ju kallxu shqiptarve se qysh bohet seksi qporrnu e dim ket pun na boll mi”, “Allahi i denofte keta te cilet po e prishin rinine” etj.⁴⁸

Zeri.info – YIHR KS ka analizuar dhjetëra shkrime të këtij mediumi që kanë të bëjnë me tematikën e komunitetit LGBT. Duhet përmendur fakti që bazuar në të gjeturat e monitorimit ky medium ka publikuar më shumë shkrime që trajtojnë sfidat e personave LGBT, por në anën tjetër komentet e publikuara shpesh herë kanë nënvlerësuar përmbajtjen e shkrimit. Komentet e lejuara nga portali fyejnë dhe njollosin gazetarin e shkrimit dhe komunitetin në përgjithësi duke bërë thirrje për veprime kriminale ndaj tyre, duke i quajtur të sëmurë dhe duke i njollosur me gjuhë denigruese.⁴⁹

Duke pasur parasysh gjuhën e urrejtjes të përdorur kundër komunitetit LGBT në shumë vende, Article 19, një organizatë e njohur ndërkombëtare e vendosur në Londër, ka publikuar një analizë e cila ofron rekomandime se si të adresohet kjo çështje.⁵⁰ Ndër të tjera, Article 19 rekomandon aprovimin e një kornize ligjore që ndalon avokimin për të urryer personat LGBT, organizimin e kampanjave edukuese dhe informuese, trajnime për zyrtarë publik dhe politikanë rreth të drejtave të komunitetit LGBT, dhe kujdes nga mediat në mënyrën e raportimit për LGBT.⁵¹

“Shkije” dhe “magjup” – shprehjet e zakonshme në komente

Botasot.info – po ashtu ka lejuar komente që përmbajnë gjuhë të urrejtjes në lajmet që kanë të bëjnë me minoritetet etnike, sidomos kur ato ndërlidhen direkt ose indirekt me komunitetin serb.⁵² Komente të tilla janë hasur edhe në një shkrim që ka të bëjë me

⁴⁸ Komentet nuk janë redaktuar qëllimisht.

⁴⁹ Më poshtë mund të gjeni disa nga linqet e shkrimeve të analizuar. YIHR KS posedon të gjitha shkrimet dhe komentet në kopje fizike.

Kosova pranon paradë homoseksualësh, 06 nëntor 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/19839/kosova-pranon-parade-homoseksualesh>

Ekrani i madh i seksit të njëjtë, 28 shtator 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/16065/ekrani-i-madh-i-seksit-te-njejte>

Për seksin, me zë të ulët!, 11 shtator 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/14686/per-seksin-me-ze-te-ulet>

Shtirja homoseksuale në Kosovë dhe Ballkan, 28 gusht 2013, mund të gjendet në:

<http://www.zeri.info/artikulli/13399/shtirja-homoseksuale-ne-kosove-dhe-ballkan>

Transvestitja serbe e rrugëve të Prizrenit, 25 gusht 2013, mund të gjendet në:

<http://www.zeri.info/artikulli/13117/transvestitja-serbe-e-rrugeve-te-prizrenit>

Mentaliteti turk vështirë e pranon homoseksualitetin, 21 gusht 2013, mund të gjendet në:

<http://www.zeri.info/artikulli/12749/mentaliteti-turk-veshtire-e-pranon-homoseksualitetin>

Incidenti në “Kosovë 2.0”, 12 persona në kërkim nga Policia (FOTO), 07 qershor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.zeri.info/artikulli/7390/incidenti-ne-kosovo-20-12-persona-ne-kerkim-nga-policia-foto>

Hoxhaj: S’na duhet islami i importuar, 03 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/24055/hoxhaj-sna-duhet-islami-i-importuar>

⁵⁰ Përgjigje ndaj gjuhës së urrejtjes kundër njerëzve LGBT, Article 19, tetor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.article19.org/data/files/medialibrary/37343/LGBT-Incitemment-Paper-30-Sept-AS-FINAL.pdf>

⁵¹ ibid

⁵² Më poshtë mund të gjeni disa nga linqet e shkrimeve të analizuar. YIHR KS posedon të gjitha shkrimet dhe komentet në kopje fizike

Ivanovic: Betimi në komnatat e veriut pa simbole shtetërore, 08 janar 2014, mund të gjendet në:

<http://www.botasot.info/kosova/263158/ivanovic-betimi-ne-komnatat-e-veriut-pa-simbole-shteterore/#faqe1>

Profecia e Zafir Berishës, 08 janar 2014, mund të gjendet në <http://www.botasot.info/kosova/263152/profecia-e-zafir-berishes/>

Në Jarinjë e Bërnjak nuk ka filluar pagesa e sigurimit kufitar, 08 janar 2014, mund të gjendet në:

<http://www.botasot.info/kosova/263102/ne-jarinje-e-bernjak-nuk-ka-filluar-pagesa-e-sigurimit-kufitar/>

hebrejntë, kur ata përmes komenteve quhen “çifutë”, fjalë kjo që mund të nxisë urrejtje.⁵³ YIHR KS i është drejtuar këtij mediumi me shkrim, me kërkesë për të hequr komentet diskriminuese që gjenden në më shumë se pesë shkrime, por nuk ka hasur në mirëkuptim.

Indeksonline.com – edhe ky portal nuk ka ndalur komentet në të cilat për të treguar jo tolerancën ndaj minoriteteve etnike dhe në veçanti ndaj komunitetit serb, janë bërë komente denigruese përfshirë thirrje për vrasje e “dënime” të llojllojshme.⁵⁴ Në një rast, në shkrimin me titull “I dyshuari është ashkali”, portali nuk është dashur të identifikoj përkatësinë etnike pasi që nuk është relevante nëse i dyshuari është shqiptar apo ashkali, por ai vetëm duhet të identifikohet si i dyshuar. Identifikimi i përkatësisë etnike në rastet që përfshijnë vepra penale është diskriminuese dhe mund të çojë në krijimin e paragjytimeve, stereotipeve dhe nxitje të urrejtjes.⁵⁵ Gjithashtu, në shumë shkrime, ashtu si edhe në Telegrafi.com dhe në faqe të tjera, është lejuar shprehja denigruese “magjup”, “shkije” etj.

Gazetatribuna.com – Poashtu edhe në këtë portal është lejuar në disa shkrime fjala “shki” ose “shkije” në shkrime në të cilat ose përmendeshin serbët në ndonjë formë, ose nuk përmendeshin fare, por si duket është përdorur si shprehje për të treguar urrejtjen ndaj një personi të caktuar.⁵⁶

Mrkiq: Mes Kosovës e BE-së, Serbia zgjedh Kosovën, 05 janar 2013, mund të gjendet në:

<http://www.botasot.info/lajme/262344/mrkiq-mes-kosoves-e-be-se-serbia-zgjedh-kosoven/> Vuçiq: Protesta në Gjakovë ishte demonstrim i urrejtjes, 07 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.botasot.info/lajme/262890/vuciq-protesta-ne-gjakove-ishte-demonstrim-i-urrejtjes/>

Serbia propozon Ambasada ballkanike nëpër botë, 05 janar 2014, mund të gjendet në:

<http://www.botasot.info/lajme/262294/serbia-propozon-ambasada-ballkanike-neper-bote/>

Kandiq: EULEX gaboi që e liroi Lushtakun për betim, 05 janar 2014, mund të gjendet në:

<http://www.botasot.info/lajme/262242/kandiq-eulex-gaboi-qe-e-liroi-lushtakun-per-betim/>

Shteti i Kosovës nuk u ka borxh as një cent të burgosurve politikë, 04 janar 2014, mund të gjendet në:

<http://www.botasot.info/kosova/262210/shteti-i-kosoves-nuk-u-ka-borxh-asnje-cent-te-burgosurve-politike/>

⁵³ Hebrejntë nga Prishtina: Jemi dëbuar, do ta padisim Kosovën, 26 maj 2013, mund të gjendet në:

<http://www.botasot.info/kosova/224992/hebrejnte-nga-prishtina-jemi-debuar-do-ta-padisim-kosoven/>

⁵⁴ Ky nuk është Gjuriq, 22 tetor 2013, mund të gjendet në: <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=73937>

Serbia doli e shpërblyer, 19 dhjetor 2013, mund të gjendet në: <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=79310>

Serbia nuk merr pjesë në Eurovision 2014, 22 nëntor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=4&LajmID=76957>

Serbia më 2060 do t'i ketë vetëm 4.5 milionë banorë, 05 janar 2014, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=80782>

Serbia u rikthehet vijave të kuqe për Kosovën, 24 dhjetor 2014, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=79808>

Lekaj shpërndan miell, reagon AKR-ja, 24 nëntor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=77063>

Deputeti i PD-së, Kelmendi, e quan Skënderbeun hero të katolikëve, 10 qershor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=61394>

⁵⁵ I dyshuari është ashkali, 15 janar 2013, mund të gjendet në: <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=44212>

⁵⁶ YIHR KS ka identifikuar disa artikuj që kanë të bëjmë ne LGBT-të dhe minoritet kur është lejuar gjuhë e urrejtjes. Poashtu, në një shkrim është publikuar titulli që përmban fjalën “çifut”. Kjo fjali konsiderohet diskriminuese dhe që mund të nxisë urrejtje ndërsa fjala e duhur është hebre.

Shih linqet e analizuara:

Hapen detaje rreth burgut të Likovcit, 27 maj 2013, mund të gjendet në: <http://gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmID=9524>

Buzhala: Po më “kërcnojnë” katolikët e Palit!, 05 tetor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmID=26137>

Ëndërroj ta heq barrikadën mbi urë, 30 prill 2013, mund të gjendet në:

<http://www.gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmID=6450>

Hashim Thaçi: Isa e humbi Prishtinën, i fitoi katundet, 21 nëntor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.gazetatribuna.com/?FaqeID=2&LajmID=32536>

Koha.net - Në këtë portal është vërejtur një numër më i madh i shkrimeve që kanë të bëjnë në veçanti me serbët, ku janë lejuar komente të ndryshme që nxisin urrejtje. Një ndër shprehjet me të shpeshta që është lejuar është fjala “shkije” dhe shprehje tjera poshtëruese kundër serbëve.⁵⁷

Telegrafi.com – niveli i komenteve kundër serbëve dhe minoriteteve tjera etnike, në përgjithësi është i lartë dhe mund të krahasohet me atë të Indeksonline.com. Shprehjet denigruese, fyese, poshtëruese, në kundërshtim me kodin e etikës dhe ligjet në fuqi janë të zakonshme në shkrimet e këtij portali, kur trajtojnë çështjet që kanë të bëjnë me serbët, minoritetet e tjera etnike, veriun e vendit etj.⁵⁸ Kjo është alarmuese, posaçërisht duke pasur parasysh faktin që ky portal përveç që posedon shënimin për ndalimin e gjuhës së urrejtjes, ka krijuar edhe një udhëzues të detajuar për komentuesit. Mirëpo, fatkeqësisht këto rregulla nuk respektohen fare nga ana e portalit.

Zeri.info⁵⁹ – Ky medium ka publikuar komente ku personat e përfolur në shkrime quhen “shkije” dhe fyhen në gjuhën serbe dhe me shprehje të pista. Shprehjet e tilla nuk janë

⁵⁷ Më poshtë mund të gjeni disa nga linqet e shkrimeve të analizuar. YIHR KS posedon të gjitha shkrimet dhe komentet në kopje fizike

Hoxhaj: LDK-ja ta mbajë premtimin për vendet e rezervuara, 26 dhjetor 2013, mund të gjendet në:

http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,170470&s&ch=0&f_d=26.12.2013&t_d=26.12.2013

PTK I paguante haraç Zvonko Veselinoviçit, 29 prill 2013, mund të gjendet në: <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,97446>

“Mbrojtja Civile” mund të jetë partnere e KFOR-it, 14 maj 2013, mund të gjendet në:

http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,145743&s&ch=0&f_d=14.05.2013&t_d=14.05.2013

Serbët djejin materialin ndërtimor të një shtëpie shqiptare në veri, 17 nëntor 2012, mund të gjendet në:

<http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,123628>

Protesta të Serbëve në Graçanicë, 23 tetor 2012, mund të gjendet në: <http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,120177>

Tifozët serb për nesër paralajmërojnë konfrontim me shqiptarët!, 15 tetor 2012, mund të gjendet në:

<http://www.koha.net/arkiva/?page=1,20,119094>

Vriten dy shtatarë serbë në kufi me Kosovën nga shpërthimi i një bombe, 01 gusht 2012, mund të gjendet në:

<http://www.koha.net/arkiva/?page=1,15,109740>

UNMIK-u nuk di çfarë të bëjë me administratën e vet, 31 maj 2012, mund të gjendet në:

<http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,101565>

SHBA inkurajojnë dialogun Kosovë – Serbi për veriun, 07 mars 2012, mund të gjendet në:

<http://www.koha.net/arkiva/?page=1,13,90575>

⁵⁸ Më poshtë mund të gjeni disa nga linqet e shkrimeve të analizuar. YIHR KS posedon të gjitha shkrimet dhe komentet në kopje fizike

Martohet me serb, refuzon shtetin e Kosovës!, 27 prill 2012, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/martohet-me-serb-refuzon-shtetin-e-kosov-s-2-22036.html>

Rrënohen 27 përmendore të varrezave serbe në Kllokot, 20 janar 2013 mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/rrenohen-27-pemendore-te-varrezave-serbe-ne-kllokot-2-28323.html#comment-773443122>

RTS-i serb akuzon se po ngrit tensionet, 27 janar 2013, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/rts-i-serb-akuzon-kurtin-se-po-ngrit-tensionet-2-28552.html>

Hoxhaj pi kafe me homologun serb, Mrkic, 29 shtator 2013, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/hoxhaj-pi-kafe-me-homologun-serb-mrkic-2-36648.html>

Komandanti i policisë në very pjesëmarrës në vrasjen e familjes Jashari?! , 22 tetor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/komandanti-i-policise-ne-veri-pjesemarrres-ne-vrasjen-e-familjes-jasharija-2-37243.html>

Dënohet familja Rome nga Kosova, e akuzuar për skllavëri, 04 dhjetor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/denohet-familja-rome-nga-kosova-e-akuzuar-per-skllavleri-80-6324.html>

Ivanovic: Në Mitrovicë mungoi vetëm aviacioni serb, 18 nëntor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/ivanovic-ne-mitrovice-mungoi-vetem-aviacioni-serb-2-38171.html>

Shteti serb në Kosovë pëmes Asociacionit të Komunave Serbe, 16 nëntor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/shteti-serb-ne-kosove-permes-asociacionit-te-komunave-serbe-2-38109.html>

Goranët duan komunë në kuadër të asociacionit serb, 09 nëntor 2013, mund të gjendet në:

<http://www.telegrafi.com/lajme/goranet-duan-komune-ne-kuader-te-asociacionit-serb-2-37825.html>

⁵⁹ Më poshtë mund të gjeni disa nga linqet e shkrimeve të analizuar. YIHR KS posedon të gjitha shkrimet dhe komentet në kopje fizike

shfaqur vetëm në shkrimet për serbët, por edhe për ndonjë person tjetër të përfolur në shkrim. Komente të tilla hasen edhe në shkrimet që trajtojnë shërbimet sekrete vendore apo ndërkombëtare. Për shembull në një ndër shkrimet është lejuar ky koment: “More krejt shkiet e kosoves dhe te serbis kan me dal si ushtir dhe polici dhe te tjeret kan me dal si punetor te sherbimeve tjera dhe kan me u punsuar dhe i paguan kosova me buxhet te vet”.

Lidhur me arsyet pse mediat online lejojnë komente të tilla, YIHR KS mbështet konstatimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut të dhënë në rastin Delfi As v. Estonia, sipas së cilit “numri i komenteve ka pasur ndikimin në numrin e vizitave në portal dhe në të hyrat nga reklamat... Andaj, kompania [mediumi i paditur] ka pasur interes ekonomik në komente”.⁶⁰

Qëndrimet e redaksive rreth gjuhës së urrejtjes

Pjesë e këtij raporti kanë qenë edhe intervistat me përfaqësues të mediave të cilat janë monitoruar nga YIHR KS.⁶¹ Ata kanë deklaruar se faktori kryesor që ndikon në lejimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes është mungesa e stafit, përkatësisht njohësve të legjislacionit që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes.

Konstituohen komunat veriore , nuk nënshkruan Kërstimi Pantiq, 12 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/24657/konstituohen-komunat-veriore-nuk-nenshkruan-kerstimir-pantiq#comments>
Selimi: Radikalizimi fetar rreziku më i madh i interesave nacionale, 09 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/24478/selimi-radikalizimi-fetar-rreziku-me-i-madh-i-interesave-nacional>
Kosovarëve në Serbi u kërkohet doganë!, 09 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/24425/kosovareve-ne-serbi-u-kerkojne-dogane>
Vuçiq: S’do të heqim dorë kurrë nga serbët e Kosovës (Foto), 07 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/24298/vuciq-sdo-te-heqim-dore-kurre-nga-serbet-e-kosoves-foto>
Hoxhaj “thumbon” Serbinë për idenë e ambasadave të përbashkët, 06 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/24266/hoxhaj-thumbon-serbine-per-idene-e-ambasadave-te-perbashketa>
Masakrën e Rezallë e bëri ushtria serbe, 06 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/24229/masakren-e-rezalles-e-beri-ushtria-serbe>
Medvegja në grahamat e fundit, 05 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/24171/medvegja-ne-grahmat-e-fundit>
Thaçi, i vetëm kundër Serbisë, 04 janar 2014, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/24116/thaci-i-vetem-kunder-serbise>
“Çka ka Vetëvendosja që veç po ankohet?”, 17 shkurt 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/265/ka-ka-vetevendosja-qe-vec-po-ankohet>
Marrëveshje për “Ahtisaari Plus”!, 22 shkurt 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/524/marreveshje-per-ahtisaari-plus>
Zgjedhjet në veriun e Kosovës – në shtator, 26 shkurt 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/798/thaci-e-informoi-jahjagen-per-dialogun-ne-bruksel>
Thaçi shkeli rezolutën e Kuvendit, 25 shkurt 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/701/thaci-shkeli-rezoluten-e-kuvendit>
MUP dhe BIA aktive në veri, 05 mars 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/1224/mup-dhe-bia-aktive-ne-veri>
Miell e grurë i kontaminuar nga Serbia, 05 mars 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/1227/miell-e-grure-i-kontaminuar-nga-serbia>
Daçiq: Është gënjyer kush është thënë se Kosova është Serbi, 07 mars 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/1404/daciq-shte-genjyer-kur-eshte-thene-se-kosova-eshte-serbi>
Veriut po i “vjen fundi”, 10 mars 2013, mund të gjendet në: <http://www.zeri.info/artikulli/1559/veriu-po-i-vjen-fundi>
⁶⁰ Delfi As v. Estonia, 10 tetor 2013, GJEDNJ, mund të gjendet në: [http://hudoc.echr.coe.int/sites/fra/pages/search.aspx?i=001-126635#{"itemid":\["001-126635"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/fra/pages/search.aspx?i=001-126635#{)
⁶¹ Intervistat janë bërë përmes e-mailit

Sipas kryeredaktorit të Koha.net, Zenun Çelaj, ky medium nuk ka mundur të jetë imun në lejimin e gjuhës së urrejtjes për shkak të shpejtësisë së punës dhe mungesës së stafit të mjaftueshëm.⁶² Portali ka krijuar kufizim automatik të shprehjeve fyese dhe banale nga komentet.⁶³

Shprehja “shkije” e cila është hasur në shumë shkrime të Koha.net, nuk konsiderohet si shprehje fyese pasi që kjo fjalë vjen nga përdorimi i vjetër i emërimit për sllavet, sipas kryeredaktorit Çelaj.

Ndërsa, ndihmëskryeredaktori Artan Haraqija nga Zeri.info përmend poashtu si arsye mungesën e stafit të veçantë dhe ekspertit që njeh ligjet që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes për të kontrolluar të gjitha komentet.⁶⁴ Sipas tij, është vërtetuar që ka qenë gabim lejimi i komenteve të pa filtruara në të kaluarën dhe po punohet që komentet të kontrollohen me kujdes.

Sa i përket Telegrafi.com, aty qasje në aprovimin e komenteve kanë të gjithë gazetarët sipas rubrikave të tyre ndërsa komentet filtrohen automatikisht dhe manualisht.⁶⁵ Në disa raste, mbyllet edhe mundësia e komentimit në artikuj të këtij portali ndërsa kohët e fundit moderimi është më i kujdesshëm dhe ka raste kur diskutuesit online përjashtohen nga forumi i diskutimit.⁶⁶

7. Shembuj pozitiv

Megjithatë, situata nuk qëndron aq keq, pasi jo të gjitha mediat online “keqpërdorin” lirinë e të shprehurit duke lejuar përmbajtje të llojllojshme në platformat e tyre. Dy portale, relativisht të reja, deri më tani kanë treguar rigorozitet dhe respektim të plotë të legjislacionit që rregullon mediat sa i përket përmbajtjes që ofrohet nga lexuesit përmes komenteve.

Gazetajetane Kosove.com - nuk ka lejuar publikimin e komenteve që nuk janë në përputhje me rregullat e tyre për diskutimin online. Kjo platformë online, ka hartuar udhëzues për orientimin e lexuesit se si të diskutohet online dhe duket se është e vetmja që e respekton. Sipas udhëzuesit, “lexuesi inkurajohet të fokusohet në diskutimin konstruktiv të temës për të cilën është shkruar dhe të përmbahet nga sulmi i gazetarëve, personave të përfolur në shkrim ose të tjerëve dhe se nuk lejohet përdorimi i gjuhës raciste, diskriminuese, denigruese, të urrejtjes ose të nxitjes së veprimeve kriminale⁶⁷.

Lajmi.net - një tjetër ueb-faqe e lajmeve, që fokusohet në politikë dhe lajme nacionale, poashtu nuk lejon përmbajtje denigruese në komente dhe deri më tani është treguar shumë e kujdesshme gjatë redaktimit të komenteve. Pleurat Halili, një ndër anëtarët e bordit redaktues të kësaj ueb-faqeje, në një kolumne të tijën shprehet se: “dëshiroj të

⁶² Zenun Çelaj, kryeredaktor i Koha.net, 22 janar 2014

⁶³ Ibid

⁶⁴ Artan Haraqija, ndihmëskryeredaktor, Zeri.info, 22 janar 2014

⁶⁵ Përgjigje nga Telegrafi.com, 22 janar 2014

⁶⁶ Ibid

⁶⁷ Gazeta Jeta në Kosovë, Diskutimi online, mund të gjendet në: <http://gazetajn.com/?cid=1,1061>

njoftoj me krenari për politikën redaktuese të lajmi.net rreth komentimeve të lexuesve. Redaksia redakton, e nëse është e nevojshme edhe ndalon, komentet ofenduese dhe që nxisin urrejtje”.⁶⁸

8. Raste ilustrative

Kosovo 2.0

Ngjarjet që pasuan organizimin e publikimit të revistës Kosovo 2.0 me titull “Seksi”, janë dëshmi e qartë e rrezikut të drejtpërdrejtë që mund të kanoset nga lejimi i përdorimit të gjuhës fyese, denigruese e që nxitë urrejtje në mediat online, qofshin ato platforma sociale apo ueb-faqe të lajmeve.

Kosovo 2.0, më 14 dhjetor 2012 kishte organizuar publikimin e revistës së radhës që trajtonte seksualitetin dhe tema të tjera që lidheshin me seksin, përfshirë edhe jetën e komunitetit LGBT. Ftesa për të marrë pjesë ishte bërë në forma të ndryshme, përfshirë edhe krijimin e një “eventi” në Facebook, përmes së cilit ftoheshin një numër i madh i njerëzve në promovimin e revistës.

Besohet që “eventi” i krijuar në Facebook kishte nxituar reagimin e grupeve ekstremiste që të kundërshtonin publikimin e kësaj reviste, me ç’rast një grup të rinjsh, përfshirë përfaqësues të tifozëve “Plisat” dhe të rinj që brohorisnin “Allahu Akber”, kishin sulmuar ambientet ku po mbahej ngjarja. Si rezultat, skena ishte demoluar dhe një person ishte sulmuar fizikisht.⁶⁹

Aktakuza e ngritur nëntë muaj më vonë, më 4 shtator 2013, ngarkon Latif Gashin, Driton Dilin dhe drejtuesin e “Plisave”, Albert Kastratin me veprat penale shkelje në bashkëkryerje të statusit të barabartë të banorëve të Kosovës, parandalim ose pengim në bashkëkryerje të takimit publik, bashkëkryerje në nxitje të urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar e etnik, dëmtim në bashkëkryerje të pronës së luajtshme dhe shkaktim në bashkëkryerje të lëndimit të lehtë trupor.⁷⁰

Ajo që është për t’u shqetësuar, është fakti që aktakuza nuk i referohet fare mediave online dhe rolit që ato kanë luajtur në këtë ngjarje. Sipas Gazetës Jeta në Kosovë, disa prej ftesave për të kundërshtuar këtë ngjarje, ishin bërë përmes Facebook.⁷¹ Kosova është e obliguar që të ndjek penalisht krimet e urrejtjes, edhe kur vinë nga mediat online, meqenëse synon t’i bashkohet familjes Evropiane. Ndërkohë që, Këshilli i Evropës, së voni rekomandoi përsëri që shtetet anëtare të sigurojnë hetim dhe ndjekje të shpejtë dhe efektive të krimeve të urrejtjes.⁷²

⁶⁸ Pleurat Halili, Keqkuptimi i lirisë së shprehjes, 2 tetor 2013, mund të gjendet në: <http://lajmi.net/keqkuptimi-i-lirise-se-shprehjes/>

⁶⁹ Nata e turpit, Gazeta Jeta në Kosovë, 20 dhjetor 2012, mund të gjendet në: <http://gazetajn.com/?cid=1,979,4180>

⁷⁰ Ibid.

⁷¹ Ibid.

⁷² Konkludime të Këshillit të Europës në luftimin e krimeve të urrejtjes në Bashkimin Evropian, 5 & 6 dhjetor 2013, Bruksel, mund të gjendet në: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_Data/docs/pressdata/en/jha/139949.pdf

Një vit pas ngjarjeve që ndërlidheshin me Kosovo 2.0 dhe katër muaj pas ngritjes së aktakuzës gjykim i rastit ende nuk ka filluar dhe asnjë seancë gjyqësore nuk është mbajtur.

Alma Lama

Bazuar në hulumtimin e YIHR KS-së, Alma Lama konsiderohet si një ndër personat më të sulmuar përmes komenteve, ndaj së cilës është përdorur gjuhë e urrejtjes. Deputetja Lama thotë se e tëra filloi pas një fjalimi që bëri në Kuvend, ku tha se ka rritje të fundamentalizmit islamist.⁷³ Si rezultat, një forum i quajtur “Forumi i të Rinjve Muslimanë” kishte reaguar përmes një komunikate në lidhje me fjalimin e saj në kuvend, përmes së cilës kërkonin “linçimin” e saj, marrjen e shtetësisë etj. Kjo komunikatë është publikuar nga shumë medime të shkruara dhe online.

Deputetja Lama fajëson se disa media botuan komunikatën që kërkonte “linçimin” e saj, pa e verifikuar se kush ishte ky forum dhe në përgjithësi medimet nuk e kanë trajtuar rastin në mënyrë profesionale. Si rrjedhojë e publikimit të kësaj komunikate, portalet e ndryshme nuk kanë qenë të kujdesshme në filtrimin e komenteve të lexuesve që përmbanin gjuhë të urrejtjes. Ajo thotë se është krijuar opinion publik, nga këto komente se ajo është “anti muslimane”, dhe për këtë ka marrë shumë kërcënime, të cilat i ka paraqitur edhe në polici.

Poashtu, vitin e kaluar ajo kishte akuzuar Lëvizjen Vetëvendosje se po paguante njerëz që të komentonin në portale, akuza këto që janë mohuar nga kjo lëvizje. Deputetja Lama është larguar nga kjo lëvizje dhe i është bashkuar Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndërsa kishte përmendur faktin që Lëvizja Vetëvendosje mbështeste përdorimin e shamive në shkolla pas moshës 16 vjeçare.

“Vajza rome”

Leonarda Dibrani, një vajzë 15 vjeçare, u deportua nga Francë për në Kosovë në nëntor të vitit të kaluar. Largimi i saj për në Kosovë ishte spektakolar, pasi që policia e nxorri atë nga autobusi i shkollës dhe ta prangosur dhe e deportoi për në Kosovë. Ministria e Brendshme e Francës konstatoi që deportimi ishte në përputhje me ligjet franceze, pasi që babai i vajzës Dibrani nuk kishte vepruar në mënyrë të ligjshme.⁷⁴

Vajza dhe familja e saj i takojnë komunitetit rom. Ky fakt është dashur të përmendej nga mediat në kontekstin që Franca tashmë është e njohur në Evropë për politikë rigorozë dhe ndoshta diskriminuese ndaj minoriteteve etnike, pasi që ka larguar me dhjetëra romë nga Parisi dhe vendet e tjera.

Mirëpo, referenca si vajzë rome në tituj, edhe në shkrimet pasuese, derisa raportohej për ngjarjet që e pasuan jetën e saj pasi u kthye në Kosovë, lë shumë për të dëshiruar.

⁷³ Intervistë me Alma Lama, 20 janar 2014

⁷⁴ Leonarda Dibrani Ende Nuk Shkon në Shkollë, 4 nëntor 2013, mund të gjendet në: <http://www.gazetajnk.com/?cid=1,979,6940>

Për shkak të mediave online, Leonarda Dibrani së bashku me familjen e saj u stigmatizuan, u diskriminuan dhe denigruan pa masë.

Zëri.info e fillon shkrimin me titull “Leonarda Dibrani mund të kthehet në Francë”, me fjalët “romja Leonarda”. Në shkrim mund të përmendet fakti që ajo i takon kësaj përkatësie etnike dhe për këtë mund ta kenë dëbuar nga Franca, por në asnjë mënyrë të quhej rome në shkrim.⁷⁵ Nëse krahasohet me mënyrën se si trajtohen shqiptarët, gjasat janë minimale që një shkrim t’i referohet një personi si “shqiptar N.N”. Në të njëjtin shkrim, janë lejuar komente si: “Magjupja e Italisë. Perse ne i kushtojme kaq shume rendesi nje problemi te till? Gjat luftes se fundit ne Kosove magjupet kan pre Shqiptar me motor te drurit ne oborr te kishes.”⁷⁶

Portretizim i njëjtë, asaj i është bërë edhe nga Telegrafi.com, sidomos përmes lejitit të komenteve. Në njërin ndër komentet e lexuesve ajo quhet “llo”⁷⁷ – “Ktu krejt llomin e dyjes ta shkarkojn e asnji qeveritar nuk e livrit venin e vet”.⁷⁸ Ndërsa në një koment tjetër familja e saj quhet “gabele”⁷⁹ – “ton ket buj ne madia nje familje gabele boll mbare.. !!!! qa kan keta lidhje me shiptar, pse flisni per keta”⁸⁰. Njëjtë ajo dhe familja e saj janë quajtur edhe në komentet e lejuara nga portali Indeksonline.net. Disa prej komenteve janë “o hajdi gabel se e bat kahre dyjan se sjini te shkolles ju”⁸¹ dhe “gjinahe magjupja e vogel. ne kosove i rrezikohet jeta nga fukarallaku jo nga shqiptaret. se ne mahall te magjupve si nguc kush bile ju kan maru banesa ter eja me nxemje.”⁸²

“Gjenocidi modern”

Më 23 prill 2013, Botasot.info ka publikuar një paragraf të një teksti që mban titullin “Martesat me sllavë, gjenocid modern”⁸³. Shkrimi nuk kuptohet a është koment i mediumit, intervistë, hulumtim, reportazh apo cilit zhanër të gazetarisë i përket.

Mirëpo, ajo që lë të kuptohet është se trajton çështjen e femrave shqiptare që martohen në Serbi dhe se ato “detyrohen të ndërrojnë emër, kombësi dhe gjuhë”. Në të vërtetë duket se promovon jotolerancën ndaj serbëve dhe komentet e lejuara nën shkrim çojnë në këtë përfundim. Një ndër komentet bën thirrje për “prerje të kokës” për të gjithë që “përfitojnë nga kjo mizeri” dhe quan “lavire” vajzat që martohen me serb.

⁷⁵ Leonarda Dibrani mund të kthehet në Francë, 19 tetor 2013, mund të gjendet në: <http://zeri.info/artikulli/18130/leonarda-dibrani-mund-te-kthehet-ne-france>

⁷⁶ Komenti nuk është redaktuar qëllimisht

⁷⁷ Familja Dibrani: Gënjem se jemi nga Kosova, 18 tetor 2013, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/familja-dibrani-genjem-se-jemi-nga-kosova-2-37162.html>

⁷⁸ Komenti nuk është redaktuar qëllimisht

⁷⁹ Familja e Leonardës ndodhet në stacionin policor, 20 tetor 2010, mund të gjendet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/familja-e-leonardes-ndodhet-ne-stacionin-policor-80-6089.html>

⁸⁰ Komenti nuk është redaktuar qëllimisht

⁸¹ Leonarda Dibrani: Nuk kthehem në Francë pa familjen time, 19 tetor 2013

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=73621>

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=73438>

⁸² L. Dibrani: Shtëpia ime nuk është në Kosovë, por në Francë, 17 tetor 2013,

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=73438>

⁸³ Martesat me sllavë, gjenocid modern , 23 prill 2013, <http://ëëë.botasot.info/lajme/221210/martesat-me-sllave-gjenocid-modern/#faqe2>

Në një kohë kur Kosova dhe Serbia mundohen të normalizojnë marrëdhëniet në mes tyre, një debat publik i bazuar në urrejtje dhe jotolerancë nuk ndihmon vendin të shkojë përpara, por bën të kundërtën. Andaj, roli i mediave është që të prodhojnë dhe mbështetin diskutim konstruktiv, të bazuar në fakte reale dhe duke mbrojtur reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve.

24 9. Ankesat strategjike të YIHR KS-së

Në kuadër të përpjekjeve që YIHR KS ka bërë për të ngritur vetëdijen e medimeve lidhur me gjuhën e urrejtjes, ka dërguar ankesa edhe në Këshillin e Mediave të Shkuara të Kosovës, që është trup vetë-rregullativ që merret me anën etike të mediave. Edhe pse, Telegrafi.com dhe Indeksonline.net nuk janë anëtare të KMSHK, ky organ ka të drejtë që të publikoj opinionione edhe për mediumet që nuk janë anëtare. Më poshtë është një elaborim i shkurtër i rasteve të dërguara dhe vendimet e marra.

Telegrafi.com

Ankesa e parë është bërë kundër Telegrafi.com⁸⁴ të cilët në faqen e tyre zyrtare në Facebook kanë përdorur gjuhë që mund të nxisë urrejtje kur krijuan një sondazh me pyetjen: *A ka qenë i drejtë dëmtimi i varrezave serbe si "hakmarrje" ndaj largimit të lapidarit në Preshevë?*, të publikuar më 22 janar 2012.

YIHR KS në këtë ankesë është ankuar edhe për lejimin e komenteve që përmbanin shprehje denigruese me qëllim të lëndimit dhe kërcënimit të një grupi mbi baza të përkatësisë etnike, si dhe thirrje për të kryer vepra të ngjashme. Komentet janë lejuar në lajmin *"Rrënohen 27 përmendore të varrezave serbe në Kllokot"* dhe përmbajnë fjalë ofenduese si "shkie", si dhe bëjnë thirrje për dhunë sikurse me "shemb Gazimestanin".

Këshilli i Mediave ka miratuar pjesërisht ankesën duke u arsyetuar në faktin se portali në këtë rast ka të drejtë të parashtrojë pyetje [siç ka bërë me sondazh]. Mirëpo, Këshilli nuk ka ofruar arsyetim të bazuar lidhur me të "drejtën" e mediumit që të parashtrojë pyetje përmes një sondazhi të krijuar në Facebook. Në fakt, ashtu si konstatimet dhe deklaratat e palëve edhe pyetjet duhet t'i nënshtrohen kodit etik dhe ligjor, dhe rrjedhimisht një medium nuk mund të parashtrojë çfarëdo pyetje. Për shembull, shtrohet pyetja, nëse një portal mund të parashtrojë pyetjen se "a meriton të vritet personi n.n." ose "a ka qenë e drejtë vrasja e zyrtarit të vrarë në Mitrovicë"? Pra, fakti që portali përmes pyetjes në një mënyrë arsyeton veprimet hakmarrëse, nuk u konsiderua si formë e nxitjes nga KMSHK. Lidhur me këtë ankesë, KMSHK aprovoi pjesën ku YIHR KS u ankua për përmbajtjen e komenteve.

⁸⁴ YIHR KS v. telegrafi.com, opinion, KMSHK, publikuar më 9 prill 2013, mund të gjendet në: <http://presscouncil-ks.org/?cid=1,15,425>

Indeksonline.net

Më 11 janar 2013 portali Indeksonline ka publikuar lajmin me titull “Mini-Serbia në zemër të Kosovës”⁸⁵, ku nën artikull ka publikuar disa komente ku përdoren shprehje denigruese me qëllim të lëndimit dhe fyerjes së një grupi mbi baza të përkatësisë etnike.

Në këtë rast, KMSHK gjeti që komentet e publikuara përmbanin gjuhë të urrejtjes dhe miratoi ankesën e YIHR KS, duke iu bërë thirrje portaleve që “të përmbahen nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes dhe të kenë kujdes të shtuar gjatë publikimit të komenteve të lexuesve të cilat shpeshherë kanë përmbajtje që bien ndesh me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.⁸⁶

Edhe pse KMSHK ka miratuar ankesën, fatqësisht kjo nuk ka ndikuar që portali në fjalë të marrë masa për të larguar komentet. Kjo dëshmon që fuqia ligjore e KMSHK-së është e vogël dhe se puna e tij varet ekskluzivisht nga vullneti i drejtuesve të industrisë mediale.

10. Vendime të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Edhe pse ky raport argumentoi që institucionet gjyqësore kanë trajtuar një numër jashtëzakonisht të vogël të rasteve që kanë të bëjnë me veprën penale të nxitjes së urrejtjes, është e nevojshme që të përshkruhen rastet kryesore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes. Këto raste mund të zbatohen në Kosovë përmes Gjykatës Kushtetuese, mirëpo edhe gjykatat e rregullta bazuar në Kushtetutë, janë të obliguara të marrin në konsideratë rastet e GjEDNJ.

Vejdland dhe të tjerët v. Suedia⁸⁷

Aplikantët kishin hyrë në një shkollë të mesme, ku nuk ishin nxënës, për të shpërndarë fletushka duke iu referuar homoseksualitetit si një “tendencë devijante seksuale”, që ka një “efekt moralisht shkatërrues në thelbin e shoqërisë”. Gjithashtu, ata fajësuan “stilin e jetës” së homoseksualëve në përhapjen e “murtajës moderne-ditore” të HIV-it dhe SIDA-së dhe fletushkat pretenduan që organizatat që llobojnë për të drejtat e homoseksualëve përpiqen që të “minimizojnë pedofilinë”. Aplikantët u dënuan nga Gjykata e Lartë Suedeze për agjitacion kundër një grup kombëtar apo etnik. Mirëpo, ata pretenduan që shteti Suedez në këtë rast bëri shkelje të lirisë së shprehjes. GjEDNJ në këtë rast vendosi që deklaratat ishin serioze dhe paragjyquese, edhe nëse ato nuk ishin një thirrje e drejtpërdrejtë për akte të urrejtjes. Në të njëjtën kohë Gjykata theksoi se diskriminimi i bazuar në orientimin seksual ishte aq serioz sa diskriminimi në bazë të racës, origjinës apo ngjyrës.

⁸⁵ Mini Serbia në zemër të Kosovës, 01 nëntor 2013, mund të gjendet në:
<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=75046>

⁸⁶ Opinion, KMSHK, 24 dhjetor 2013, <http://presscouncil-ks.org/?cid=1,15,459>

⁸⁷ Numri i Aplikimit 1813/07, 09 shkurt 2012

Jerslid v Danimarka⁸⁸

Z. Jerslid, një gazetar, mbajti një intervistë në radio me disa të rinj të njohur si “greenjackets”, lidhur me mendimet e tyre raciste. Gjatë intervistës, të intervistuarit shprehen disa komente poshtëruese lidhur me personat e zi. Si rezultat, z. Jerslid u dënua si bashkëfajtor në shpërndarjen e komenteve raciste, i cili bëri ankesë që kjo ishte shkelje e drejtës për liri të shprehjes. Në këtë rast GjEDNJ bëri një dallim mes personave që përdorën gjuhë urrejtëse dhe gazetarit në fjalë dhe vendosi që në këtë rast e drejta për liri të shprehjes të z. Jerslid ishte shkelur. Gjithashtu, GjEDNJ shpjegoi që ‘Raportimi i lajmeve të bazuar në intervista, të redaktuara ose jo, përbën një nga mjetet më të rëndësishme ku shtypi është në gjendje të luajë rolin e saj jetik si vigjil publik. Dënimi i një gazetari për të ndihmuar në shpërndarjen e deklaratave të bëra nga një person tjetër në një intervistë do të pengonte seriozisht kontributin e shtypit në diskutimin e çështjeve me interes publik dhe nuk duhet të parashihen përveç nëse ka arsye veçanërisht të forta për të bërë këtë’.⁸⁹

Féret v Belgjika⁹⁰

Z. Féret ishte anëtar i Parlamentit Belg dhe Kryetar i partisë politike Fronti Kombëtar në Belgjikë. Gjatë fushatës elektorale disa fletushka ishin shpërndarë me slogane si “çohu kundër islamifikimit të Belgjikës”, “stop politikën e integritit të rremë” dhe “dërgo punëkërkuessit e huaj në shtëpi”. Lidhur me këtë z. Féret u dënua për diskriminim racor dhe gjykata vendosi të dënojë me shërbim në komunitet dhe ia ndaloi mbajtjen e pozitës në Parlament për 10 vjet. Edhe pse, z. Féret u ankua për shkelje të lirisë së shprehjes, sipas GjEDNJ komentet e z. Féret kishin për qëllim të ngjallin ndjenja të mosbesimit, refuzimit apo edhe urrejtje ndaj të huajve. Gjithashtu, mesazhi i tij gjatë një procesi elektoral arriti që të nxisë urrejtje racore. Prandaj, GjEDNJ vendosi që në këtë rast nuk kishte shkelje të lirisë së shprehjes, pasi që dënimi i z. Féret ishte justifikuar duke u bazuar në parandalimin e trazirave dhe mbrojtjen e të drejtave të tjerëve.

Vona v. Hungaria⁹¹

Z. Vona ishte kryetar i Shoqatës “Magyar Garda Egyesület”, e cila themeloi edhe Lëvizjen “Magyar Garda Mozgalom”. Anëtarët e Lëvizjes kishin veshur uniforma gjatë mitingjeve në fshatra me popullatë rome dhe retorika tyre ishte mbrojtja e hungarezëve nga e ashtuquajtura “kriminaliteti rom”. Në këtë rast Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi që shpërbërja e Lëvizjes ishte një kufizim i të drejtës së z. Vona sipas Nenit 11 (liria e asociimit). Mirëpo, kufizimi në këtë rast ishte i paraparë me ligj dhe mund të shihet se ndiqte qëllimet legjitime të sigurisë publike, parandalimin e trazirave dhe mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Gjithashtu, GjEDNJ theksoi që “shteti ka të drejtë që të marrë masa parandaluese për të mbrojtur demokracinë në qoftë se një paragjykim

⁸⁸ Numri i Aplikimit 15890/89, 01 shtator 1994

⁸⁹ Para. 35 Ibiid

⁹⁰ Numri i Aplikimit 15615/07, 16 korrik 2009

⁹¹ Numri i Aplikimit 35943/10, 09 dhjetor 2013

mjaft i afërt me të drejtat e të tjerëve kërcënon të minojë vlerat themelore në bazë të të cilave një shoqëri demokratike ekziston dhe funksionon. Një vlerë e tillë është bashkë-ekzistenca e anëtarëve të shoqërisë së lirë nga segregacioni racor, pa të cilën vlerë një shoqëri demokratike është e pakonceptueshme.”⁹²

11. Përfundim

Gjatë hulumtimit janë monitoruar një numër i madh artikujve dhe ashtu siç është paraqitur më lartë, një numër i madh i redaksive të mediave online lejojnë gjuhë fyese, denigruese dhe poshtëruese, e cila potencialisht mund të nxisë urrejtje. Lejimi i komenteve të lexuesve në formën aktuale, pa filtrim të duhur nuk i kontribuon lirisë së shprehjes në Kosovë, e as nuk ndihmon zhvillimin e debatit publik. Në të vërtetë prodhon efekt të kundërt, atë të diskriminimit, denigrimit dhe rrezikimit të personave që iu takojnë grupeve të caktuara.

Roli i mediave është të monitorojnë punën e institucioneve publike dhe të raportojnë kur ato shkelin ligjin dhe punojnë në kundërshtim me normat morale, etike dhe kulturore. Mirëpo, kur ato gjatë punës së tyre nuk u përmbahen kodeve të etikës dhe legjislacionit për media, atëherë nuk mund të jenë të besueshme përpara publikut që të raportojnë për shkeljet e bëra nga institucionet publike.

⁹² Para. 57 Ibid

12. Rekomandimet

- 1) Mediat online nuk duhet të lejojnë komente që nxisin urrejtje;
- 2) Mediat online duhet të ofrojnë sqarim për lexuesit në raste kur komentet e tyre redaktohen apo fshihen;
- 3) Mediat duhet të konsultohen me njohës të legjislacionit për media në rastet kur ballafaqohen me përdorim të gjuhës së urrejtjes;
- 4) Mediat online duhet të informohen për bazën ligjore që rregullon nxitjen e urrejtjes, ta zbatojnë atë dhe të sigurojnë trajnim për personat përgjegjës që redaktojnë komentet;
- 5) Mediat online duhet të tregojnë kujdes të shtuar kur botojnë shkrime që kanë të bëjnë me personat LGBT dhe minoritetet etnike;
- 6) Mediat online duhet të kenë butonin për lajmërimin e rasteve ose e-mailin ku qytetarët mund të raportojnë komentet e tilla. Pas pranimit të informatës për gjuhën e urrejtjes në portale, mediat online duhet që me shpejtësi të largojnë komentet që nxisin urrejtje;
- 7) Mediat nuk duhet të përmendin përkatësinë fetare, religjioze, të gjinisë apo ndonjë karakteristikë tjetër pa nevojë dhe e cila mund të promovojë jotolerancën. Për shembull, nëse policia arreston një serb që ka vjedhur në një shitore, nuk është e nevojshme që të përmendet përkatësia etnike.
- 8) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës duhet të punojë në edukimin e qytetarëve për rrezikun e gjuhës së urrejtjes përmes kampanjave publike;
- 9) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës duhet të punojë afër me anëtarët e tij që të mos lejojnë tutje përdorimin e gjuhës së urrejtjes në portale;
- 10) Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës duhet të gjejë mënyra për të bindur portalet jo anëtare që të anëtarësohen në këtë Këshill;
- 11) Prokuroria duhet të iniciojë hetimin e krimeve të urrejtjes që bëhen në çfarëdo forme sipas detyrës zyrtare;
- 12) Prokuroria duhet të ofrojë statistika për numrin e rasteve të trajtuara, ku përfshihen rastet e krimeve të urrejtjes;
- 13) Gjykatësit duhet të trajnohen se si të gjykojnë rastet e krimeve të urrejtjes në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- 14) Avokatët duhet të vazhdojnë të trajnohen se si të ballafaqohen me rastet që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes.

